



Viti i VII-të i Botimit, Nr.2,
Dhjetor 2016

TIRANA, QYTETI I GJELBËR

Anisa Abazaj*, Eranda Shalsi**, Renis Tërshana***

* Departamenti i Arkitekturës, Albanian University

** “ARKI Atelier në Adriapol Institute”

*** EDS Foundation

Adresë kontakti: anisa.abazaj@gmail.com

Përmbledhje

Qyteti i Tiranës ka pësuar transformime dërrmuese në dy dekadat e fundit, me pasoja në jetën dhe organizimin e qytetit, veçanërisht në strukturën urbane të tij. Gjatë kësaj periudhe Tirana është përballuar me një rritje të lartë dhe të menjëhershme të popullsisë, rritje të qarkullimit të automjeteve dhe degradim të përgjithshëm të cilësisë së jetesës.

Me keqardhje mund të pranohet se Tirana sot është kthyer në një xhungël urbane.

Në të vërtetë, sipas njërës nga shumë përkufizimet që i janë bërë, “xhungla” përfaqëson një hapësirë pak të civilizuar ose të padisiplinuar jashtë kontrollit të qytetërimit.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është ta transformojmë qytetin tonë të Tiranës nga një xhungël kaotike të betonuar dhe të ndotur në kuptimin origjinal të kësaj fjale, në një hapësirë të mbuluar nga vegjetimi i dendur, të dominuar nga pemët.

Duke zhvilluar një projekt të tillë si “Tirana Jungle City”, mund t’i vijmë në ndihmë qytetit të Tiranës që të bëhet i qëndrueshëm dhe të reduktojë gjurmët e karbonit.

Në këtë kuadër, parashikohet se nëpërmjet elementit të gjelbërimit, të përdorur në të gjitha format e tij, nga një shkallë e gjerë urbane deri në elemente që i përkasin interiorit, ky projekt do të ndihmojë Tiranën në përsheptimin e kalimit nga tranzicioni, drejt një qyteti të pastër, të shëndetshëm, të qëndrueshëm dhe atraktiv.

Fjalë çelës: *xhungël urbane, degradim i cilësisë së jetesës, qytet i qëndrueshëm, qytet i gjelbër, tarracë e gjelbër, mur i gjelbër, kultivim në qytet.*

TIRANA THE GREEN CITY

Abstract

City of Tirana has undergone through significant changes in the past two decades with consequences in life and organization of the city, especially in the urban structure, with a high population growth, increased vehicle traffic and general degradation of life quality.

Tirana today, is an urban jungle.

In fact in one of its many definitions “Jungle”, represents a less civilized space unruly or out of control of civilization.

Our goal is to turn Tirana from a chaotic of cemented and polluted jungle - to a city covered with dense vegetation dominated by trees.

The project “Tirana Jungle City” through the “Green” element - used in all its forms - aims to reduce its carbon footprint and accelerate the process of transformation to a clean, healthy, sustainable and attractive city.

Choosing a natural element as the protagonist of the change is particularly interesting because it doesn't require great courage, much time and investment, but brings significant changes to the transformation of the city.

Without necessarily expecting from government and politics, do major architectural gestures we can make this change ourselves. Let's turn “GREEN” into an important part of the structure of our city.

This green super-structure, as morphological and intellectual, will be able to create a unified layer not only of the landscape of the capital, but to the overall mentality with a reinterpretation of the existing network of full and empty urban spaces.

Key words: *urban jungle, degradation of life quality, sustainable city, green city, green roof, green wall, cultivation in the city.*

Hyrje

Në 25 vitet e fundit qyteti i Tiranës ka pësuar transformime dërrmuese me pasoja në jetën dhe organizimin e qytetit, veçanërisht në strukturën urbane, me një rritje të lartë të popullsisë, rritje të qarkullimit të automjeteve dhe si rezultat, ndotje të lartë të ajrit.

Ndotja e ajrit është një nga problemet më të mëdha sot në Tiranë. Sipas raportit të vitit 2016 të Organizatës Botërore të Shëndetësisë “*Ndotja e Ajrit dhe Ambientit: Një vlerësim global dhe peshë e sëmundjeve*”, 92% e popullsisë së botës jetojnë në zona ku niveli vjetor i ndotjes është më i lartë se normat e përcaktuara nga OBSH. Për sa i përket Shqipërisë, duke iu përmbajtur statistikave të raportit të OBSH-së, Shqipëria është një ndër 15 vendet e para nga vendet e anketuara, me numrin më të lartë të vdekjeve si pasojë e sëmundjeve të shkaktuara nga ndotja e ajrit të ambientit [1]. Ataku i zemrës për shkak të ndotjes së ajrit ka shkaktuar edhe vdekjet më të mëdha në Shqipëri. Për këtë statistikë renditemi në vendin e 3-të ndër vendet e anketuara të Ballkanit Perëndimor. Njëkohësisht, edhe faqja e sondazheve të perceptimit, “Numbeo”, e rendit Shqipërinë si një ndër vendet me ajrin më të ndotur në rajon [2]. Gjithashtu, vendi ynë perceptohet edhe si vendi me ndotjen më të madhe të ujit të pijshëm, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, dhe i dyti në Ballkanin Perëndimor për papastërti. Është një fakt i konfirmuar zyrtarisht se niveli i ndotjes në Tiranë kapërcen normat e Bashkimit Evropian me mbi 20 për qind. Ndërkaq, sipas “Numbeo”-s, për Tiranën të anketuarit kanë shprehur nivelin më të lartë të pakënaqësisë për sa i përket gjelbërimit dhe parqeve në këtë qytet.

Në vitet e fundit Bashkimi Evropian ka rritur fokusin e tij në çështjet urbane, si një përgjigje ndaj faktit se deri në vitin 2020 parashikohet që pothuajse 80% e qytetarëve të BE-së do të jetojnë në qytete. Rëndësia politike e kësaj çështje është demonstruar me përfshirjen e saj në Programin e Shtatë të Veprimit në Mjedis (7EAP), të Komisionit Evropian, nën Objektivin 8, *Qytetet e qëndrueshme*: “Duke

punuar së bashku për zgjidhje të përbashkëta” (Figura 1), ku objektivi kryesor i këtyre politikave është pikërisht për të rritur qëndrueshmërinë e qyteteve të BE-së për të arritur objektivat e vëna për 2050 [3]. Në mënyrë të veçantë, Programi i Veprimit parashikon se deri në vitin 2020 shumica e qyteteve të Bashkimit Evropian do të zbatojnë politika për planifikimin urban dhe projektimin e qëndrueshëm dhe Komisioni Evropian duhet të zhvillojë një sërë kriteresh për të vlerësuar performancën mjedisore të qyteteve. Në këtë kuadër, edhe Shqipëria si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian duhet të fillojë marrjen e masave, me qëllim përmbushjen e objektivave të mësipërme, të cilat jo vetëm përmirësojnë cilësinë e qyteteve, por njëkohësisht janë një standard që duhet përmbushur në kuadër të anëtarësimit në BE.



Figura1: Objektivat me prioritet në Programin e Shtatë të Veprimit në Mjedis (7EAP) [3]

METODA

Tirana aktualisht ofron shumë pak për qytetarët e saj dhe vizitorët. Ndërsa resurset e sipërfaqes së tokës, nga dita në ditë zëvendësohen me sipërfaqe të ndërtuara për shkak të rritjes së popullsisë dhe urbanizimit. Nevoja për të rimarrë mbrapsht hapësirën e gjelbër që ka humbur, po bëhet gjithnjë e më kritike, me qëllim që të ruhet cilësia e mjedisit. Synimi kryesor i këtij projekti është që ta kthejmë qytetin e Tiranës nga një qytet kaotik të betonuar dhe të ndotur, në një qytet të gjelbër dhe të qëndrueshëm.

Kjo mund të arrihet duke lejuar natyrën të mbizotërojë mbi betonin, rregullin të mbizotërojë mbi kaosin, pastërtinë e ajrit mbi ndotjen urbane.

Le ta kthejmë Tiranën në një qytet të gjelbër, plot jetë dhe të ardhme për fëmijët tanë. Një qytet që mbase një ditë do të konsiderohet tërheqës për vizitorët e shumtë që mund të vijnë nga mbarë bota.

Duke sensibilizuar, promovuar dhe zgjeruar iniciativa që mbështesin eficiencën energjetike, si dhe përmirësimin e mjedisit urban, Tirana mund të kthehet në një qytet të qëndrueshëm.

Zhvillimi i Tiranës, nëpërmjet gjelbërimit si një formë e re e identitetit të saj, do të mundësonte njëkohësisht përmirësimin e performancës mjedisore. Ky identitet i ri i Tiranës do të ishte prova

më e fortë për të demonstruar që tashmë qyteti e ka kaluar periudhën transitore dhe është orientuar drejt shembullit të një qyteti të qëndrueshëm, plotësisht i krahasueshëm me qytete të tjera të rajonit.

Tirana
Jungle City



Tirana
Jungle City



Figura 2: Si mund të shndërrohen hapësirat publike në Tiranë [4]

Tirana
Jungle City



Tirana
Jungle City



Figura 3: Si mund të shndërrohen rrugët dhe pallatet në Tiranë



Figura 4: Si mund të shndërrohen rrugët dhe pallatet në Tiranë

Tirana
Jungle City



Tirana
Jungle City



Figura 5: Si mund të shndërrohen rrugët dhe pallatet në Tiranë

Tirana
Jungle City



Tirana
Jungle City



Figura 6: Si mund të shndërrohen tarracat e pallateve në Tiranë

Metoda

Përdorimi i gjelbërimit është një opsion që mund të zvogëlojë ndikimin negativ të zhvillimit urban, duke siguruar përfitime të shumta mjedisore, ekonomike, dhe sociale në qytet [5]. Elementi i gjelbërimit dhe mbulimi i ndërtesave është një prej strategjive që aplikohet nga bioarkitektura për të kufizuar impaktin ambiental të ndërtimit dhe të ndotjes së ajrit në përgjithësi në zonat urbane. Gjelbërimi në të gjithë format e tij (gjelbërim urban, tarracë e gjelbër, mur i gjelbër, kultivim, etj.) mundëson reduktimin e nevojës për energji të ndërtesës dhe njëkohësisht të emetimit të CO₂, por, gjithashtu, ka përparësi të tjera ekonomike, ekologjike dhe sociale në qytet, si:

- Përthith përkohësisht shirat dhe i lëshon gradualisht, duke evituar mbushjen e tepër të tubave, të sistemit të kullimit dhe redukton përmbytjet që konsiderohen dhe një nga problemet e shekullit të 21.
- Kursim të energjisë – Në vitet e fundit, i është kushtuar më shumë vëmendje izolimit të ndërtesave, si rezultat i rritjes së vazhdueshme të shpenzimeve për energjinë. Njëkohësisht, me rritjet e çmimeve të energjisë, janë përmirësuar dhe teknologjitë izoluese. Sot, shumica e materialeve të izolimit në treg janë sintetike. Megjithatë, ekziston dhe një teknikë natyrore izolimi që është e qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin [6]. Ky sistem është quajtur tarracë e gjelbër dhe konsiston në mbulimin e mbështjellës së ndërtesës me bimë. Përdorimi i tarracës së gjelbër ndikon në reduktimin e përcjellshmërisë termike, duke reduktuar kështu vartësinë nga energjitë ndotëse dhe si rrjedhojë, reduktim të drejtpërdrejtë të faturave të energjisë elektrike [7].
- Sjell ndryshime të temperaturës. Gjatë verës, temperaturat e qytetit janë afërsisht 5 -7°C më të larta se në zona rurale. Kjo është për shkak se ndërtesat dhe rrugët në zonat urbane kanë veti të absorbojnë dhe më pas të lëshojnë nxehtësi. Ky fenomen quhet efekti “Urban Heat Island”. Nëpërmjet vesës së përditshme dhe ciklit të avullimit, bimët në sipërfaqet vertikale apo horizontale janë në gjendje të freskojnë qytetin gjatë muajve të nxehtë të verës dhe të zbusin këtë efekt. Drita absorbohet nga bimët, e cila përndryshe do të konvertohej në nxehtësi [8].



Figura 7: Shembull i një tarrace të gjelbër në qytetin e Tiranës (para dhe pas)

- Hapësirat e gjelbra gjithashtu ndihmojnë përmirësimin e cilësisë së ajrit, në reduktimin e shpërndarjes së pluhurit dhe grimcave nëpër qytet, si dhe në reduktimin e smogut. Përdorimi

i bimësisë redukton CO₂ në atmosferë dhe gjeneron oksigjen. Kjo mund të luajë një rol të rëndësishëm në reduktimin e emisioneve të gazit serrë dhe në përshtatjen e zonave urbane për një të ardhme me vera të nxehta. Mjafton 1 m² hapësirë e gjelbër në vit për të eliminuar gazin karbonik dhe squfurin që lëshon një makinë në 16.000 km.



Figura 8: Kuriozitet mbi efektin purifikues të gjelbërimit në qytet

- Zbut zhurmat. Shqipëria vijon të ketë një nivel të lartë të ndotjes akustike. Listën e kryeson Tirana, ku nga 55 decibel që është vlera e lejuar gjatë ditës, ajo kap vlerën e 67dB. Sipas Agjencisë Kombëtare të Mjedisit [9], në muajin tetor është kryer një monitorim në 31 pika, në 5 qytete të ndryshme, ku Tirana dhe Vlora rezultojnë me nivelin më të lartë të zhurmave. Shkaktari kryesor i nivelit të lartë të zhurmave i atribuohet trafikut të rënduar, por nuk merret në konsideratë edhe impakti që kanë ndërtimet të cilat kanë tendencë të amplifikojnë zhurmën e trafikut. Pikërisht me qëllim amortizimit të këtyre zhurmave mjaft të dëmshme për njeriun, një ndër zgjidhjet më origjinale dhe të shëndetshme me impakt mjedisor pozitiv, është shtimi i gjelbërimit në qytet. Është provuar që sipërfaqet e gjelbëruara kanë veti shumë të mira në zbutjen e zhurmave, sidomos për tingujt me frekuencë të ulët. Një terracë ose mur i gjelbër mund të reduktojë tingujt nga jashtë deri në -40 decibel, ndërsa një terracë me gjelbërim të dendur mund të reduktojë prej -46-50 decibel [10].
- Rrit jetëgjatësinë e mbulesës së godinave (terracave).
- Ndihmon në zgjidhjen e ekosistemit të kafshëve në mjediset urbane dhe rikrijon habitate/ ekosisteme të humbura gjatë ndërtimit dhe asfaltimit të tepërt.
- Krijon hapësira rekreative për qytetarët e çdo moshe.
- Zbut vizualisht ambientin e ndërtuar dhe përmirëson gjendjen psikologjike. Është treguar që hapësira e gjelbër ka impakt pozitiv të njerëzimit që punojnë dhe jetojnë në qytet [11] (Green

Spaces, Better Places, 2002).

- Filtron ujin e papastër të shiut, etj.



Figura 9: Shembull i një muri të gjelbër në qytetin e Tiranës (para dhe pas)



Figura 10: Shembull - Godina e Piramidës e mbuluar me gjelbërim (para dhe pas)



Figura 11: Shembull - Tarraca e godinës së zyrave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e mbuluar me gjelbërim (para dhe pas)

Biznes/Interesa të përbashkëta

Shumë qytete në Botë përpiqen t'i kthehen natyrës dhe të integrojnë muret dhe tarracat e gjelbra, jo vetëm në ndërtimet e reja, por edhe në ato ekzistuese, përkrah shtimit të parqeve dhe pemëve përgjatë rrugëve. Politikat e ndërmarra nga bashkitë e atyre qyteteve që janë treguar aktive për rritjen e sipërfaqeve të gjelbra, janë të ndryshme. Përveç detyrimeve të përcaktuara në legjislacion, ato përpiqen të nxisin ndërtuesit me anë të planifikimit urban, me uljen e taksave dhe me iniciativa të ndryshme financiare, me thjeshtimin e praktikave burokratike etj. Gjithashtu, faktor i rëndësishëm është promovimi në publik dhe ndihma ndaj industrisë të sektorit *Green*.

Ndër qytet e njohura që janë treguar më aktive në promovimin e sektorit Green, mund të përmendim:

Chicago (USA) - Asistencë financiare dhe përsheptim i praktikës së lejes së ndërtimit;

Linz (Austri) - Detyrim, përfshirja e tarracave të gjelbra për çdo ndërtim të ri me 5% rimbursim nga shteti;

Copenhagen (Danimarkë) - Në të gjitha ndërtesat e reja (publike apo private) me pjerrësi më të ulët se 30%, është e detyrueshme të jenë të gjelbra;

Munich (Gjermani) - Sipërfaqet e çative mbi 100m² duhet të jenë të gjelbra;

Toronto (Kanada) - Tarracat e gjelbra të detyrueshme për ndërtesa me sipërfaqe mbi 2.000m²;

Portland (USA) - Sipërfaqe ndërtimi shtesë në rast të përdorimit të tarracave të gjelbra. Ndërtesat në pronësi të bashkisë duhet të kenë 70% të çative, të gjelbra;

Singapore - E detyrueshme ,25% e sipërfaqeve të ndërtimeve të reja të jenë të gjelbra;

Torino (Itali) - Kur nuk është e mundur t'i dedikohet 20% e sipërfaqes gjelbërimit, duhet të përdoren muret dhe tarracat e gjelbra.

Konkluzion

Zgjedhja e një elementi të natyrës si protagonist i një ndryshimi është veçanërisht interesante, pasi nuk kërkon guxim të madh, nuk kërkon shumë kohë dhe as shumë investim, por sjell ndryshime të rëndësishme në transformimin e qytetit.

Pa prituri domosdoshmërisht nga pushteti dhe politika të bëjnë gjeste të mëdha arkitektonike, këtë ndryshim mund ta bëjmë edhe ne vetë. Le ta kthejmë gjelbërimin në pjesë të rëndësishme të strukturës së qytetit tonë.

Kjo super-strukturë e re e gjelbër, si morfologjike dhe intelektuale, do të mundësojë krijimin e një shtrese të unifikuar jo vetëm të panoramës së Tiranës, por edhe të të kuptuarit ndaj ndërhyrjeve të përgjithshme me një riinterpretim të ri të një rrjeti ekzistues të hapësirave boshe dhe plote urbane.

REFERENCAT

1. OSH Organizata Botërore e Shëndetësisë (World Health Organization, WHO) <http://www.who.int/gho/countries/alb.pdf?ua=1>
2. https://www.numbeo.com/pollution/country_result.jsp?country=Albania
3. <http://ec.europa.eu/environment/action-programme/index.htm>
4. <http://junglecitcity.al/>
5. Gill, S.E; Handley, J.F; Ennos, A.R; Pauleit, S. Adapting Cities for Climate Change: The Role of the Green Infra-

- structure, Built Environment, 2007, VOL 33, NO 1.
6. http://www.efb-greenroof.eu/verband/fachbei/fa01_englisch.html
 7. Niachou, A., Papakonstantinou, K., Santamouris, M., Tsangrassoulis, A. and Mihalakakou, G., Analysis of the green roof thermal properties and investigation of its energy performance. Energy and Buildings, 2001, 33(7), pp. 719–729.
 8. Teemusk A., U. Mander, Green roof potential to reduce temperature fluctuation of a roof membrane: A case study from Estonia, Buildings and Environment, 2009, 44, pp.643-650.
 9. <http://akm.gov.al/cil%C3%ABsia-e-mjedisit.html#monitorime>
 10. <http://www.greenroofs.org/index.php/about/greenroofbenefits>
 11. http://www.ocs.polito.it/biblioteca/verde/taskforce/gspaces_.pdf



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2016

UDHËZIME PËR AUTORËT

Materialet (artikujt) i adresohen revistës *OPTIME*. Ato i nënshtrohen vlerësimit të redaksisë, e cila miraton për botim, pasi ka bërë modifikimet eventuale.

Materiali i dërgohet sekretariatit të redaksisë së *Albanian University* në adresën *Bulevardi Zogu I, Tiranë, znj. Eglantina Dervishi, email: egladervishi@yahoo.com dhe Erda Qorri, email: erdaqorri@gmail.com*

Materiali dorëzohet në 3 kopje (një origjinal dhe 2 fotokopje), si dhe në formën elektronike (me disketë). Ai duhet të shoqërohet me adresën e email-it të autorit me të cilin do të lidhet redaksia në vazhdim. Po ashtu, dorëzohet një formular, i cili duhet të firmoset nga autorët e tjerë që i delegojnë autorit kryesor kompetencat. Autorësia nënkupton që secili autor të këtë marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme në punim, aq sa të marrë përgjegjësi publike për përmbajtjen e tij. Renditja e autorëve përcaktohet nga vendimi i përbashkët i bashkautorëve.

Pasi kthehet materiali për rregullime nga autori/autorët, ai ridërgohet në formën përfundimtare.

Drejtskrimi i gjuhës shqipe është i detyrueshëm. Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjës **ë** dhe **ç**, përkatësisht me shkronjat **e** dhe **c**.

Materiali duhet të renditet sipas kësaj mënyre:

Faqja e titullit përmban:

Titullin

Emrin /emrat e autorëve (pa titujt shkencorë)

Adresat e të gjithë autorëve. Kur autorët janë në qendra të ndryshme pune, djathtas tyre bëhet një shenjë (që specifikohet më poshtë), p.sh.:

Emër Mbiemër *, Emër Mbiemër **, Emër Mbiemër ***

* Albanin University

** Fakulteti i Mjekësisë i UT

*** Ministria e Shëndetësisë

Adresa e plotë (përfshirë telefonin dhe email-in) e autorit që do të mbajë lidhje me revistën.

Abstrakti

Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht dhe përmban jo më shumë se 250 fjalë. Abstraktit në anglisht i vihet edhe titulli. Në abstrakt paraqitet qëllimi, metodat, rezultatet dhe përfundimet.

Poshtë abstraktit shkruhen fjalët kyçe. P.sh.:

Fjalë Kyçe: revistë, artikull, psikologji.

Materiali

Gjatë shtjellimit të materialit çdo referencë, figurë dhe tabelë numërohet në shifra arabe me numër rendor sipas rendit që citohen në tekst. Kur janë më shumë se 2 referenca, ato ndahen me presje).

Nuk përdoren shkurtime të tjera përveç atyre që janë përdorur në abstrakt.

Falënderimet, nëse ka, shtypen në mbarim të tekstit, pas referencave.

Referencat

Referencat shënohen në tekst me numërorë arabe sipas rendit që citohen.

Referencat shtypen në fletë të veçanta nga teksti me hapësirë dyfishe sipas stilit *Vancouver* (International Committee of Medical Journal Editors Uniform requirements for manuscripts submitted to biomedical journals). Kur lista e autorëve përbëhet nga 1 deri në 7 vetë, citohen që të gjithë. Kur ajo përmban më shumë se 7 vetë, citohen vetëm 3 të parët dhe pas të tretit, shënohet fjala et al. (ose me shkurtimin shqip *e bp.*).

Referencat përshkruhen si më poshtë:

1. Referenca e artikujve periodikë

Autorët ,Titulli, Revista, viti, volumi, faqe, p.sh. :

(1) Quilici J., Gallo R. Physiopatologie des syndromes coronariens aigus. Ann Cardiol. Angeiol 2009;148;611-23.

2. Referenca e një libri

Autori. Titulli, Vendi i botimit, Shtëpia botuese, Viti i botimit.

P.sh.:

(2) Cohen J. Return extrasystoles. New York; Grune and Stratton; 1996.

3. Referenca e një kapitulli libri

Autori kapitullit. Emri kapitullit. Emri i autorit të librit Emri i librit. Vendi i botimit. Shtëpia botuese. Viti botimit; faqet e kapitullit.

P.sh.:

(3) Baillet J. L'apport de la scintigraphie dans le diagnostic de l'embolie pulmonaire. Në: Chiche P La maladie thrombo-embolique pulmonaire Paris; L'Expansion scientifique française; 1969, f. 107-34.

Shkrimet që nuk u përmbahen këtyre udhëzimeve do t'u rikthehen autorëve për rishikim pa u marrë në shqyrtim.

Redaksia